ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Për: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **214-24-12073-2-2-5**

Sa i përket tenderit për: **MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA-RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"All Stone" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkabaj, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi) *(Kodi postar)*

045 444 999

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Muhamet Konushefci

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

***all-stone*@hotmail.com**

(Adresa elektronike)

06.12.2024

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontrate i datës 15.11.2024.

2. Dosja e tenderit e datës 15.11.2024.

3. Procesverbali i hapjes i datës 19.11.2024.

4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se B-58, i datës 10.12.2024.

5. Kërkesa për rishqyrtim e datës 12.12.2024.

6. Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 13.12.2024.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	x				**Jo**		

Në rregulll, sipas kohës së paraparë për hapjesn e ofertave

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po					**Jo**		

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:
Neni 1 Qëllimi,
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e

Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te RrUOPP-se.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pakënaqur me Vendimin e AK-se - P**OLICIA E KOSOVËS** te datës 10.12.2024 me te cilën ka rekomanduar për kontrate një OE te pa përgjegjshëm ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA-RITENDER me nr. te prokurimit: 214-24-12073-2-2-5 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, e ushtrojmë këtë ankese pranë OSHP-se:

Për shkak se AK- P**OLICIA E KOSOVËS**:

- ne mënyre te kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate një OE tjetër i cili është i pa përgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Autoriteti Kontraktues P**OLICIA E KOSOVËS** me datën 10.12.2024 ka Publikuar njoftimin B58 ku ne mënyre te kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate një OE tjetër i cili është i pa përgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

AK ne NJK dhe DT ka vendosur kërkesën si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofrojë listën mbi makineritë e nënshkruar dhe vulosur nga OE për makineritë si në vijim

6. min 1 autobartës kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme minimum 5 tone.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1 OE duhet të ofrojë listën e makinerisë të kërkuara për ekzekutim të shërbimeve punëve e vulosur dhe nënshkruar, si ne vijim :

6. min 1 autobartës kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme minimum 5 tone. Të dëshmohet me librezë valide per makinerit (nëse regjistrohet makineria) nëse OE nuk i ka pronësi të dëshmohen kontrata marrëveshja për marrjen me qira. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.

Pra AK ne piken 6 ka kërkuar **6. min 1 autobartës kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme minimum 5 tone.** Si dëshmi ka kërkuar **6. min 1 autobartës kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme minimum 5 tone. Të dëshmohet me librezë valide per makinerit (nëse regjistrohet makineria) nëse OE nuk i ka pronësi të dëshmohen kontrata marrëveshja për marrjen me qira. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.**

Ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar Kamion me Kran i cili nuk i plotëson kerkeat e AK-se pra ky OE eshte i pa pergjegjeshem dhe eshte dashur te eliminihet nga ana e AK-së.

Me poshtë e keni marrëveshjen dhe librezën e kamionit me kran i cili nuk eshte Autobartes kran per transportin e automjeteve te pa levizeshme.



A	Numri i regjistrimit: / Број регистрације: / Registration number:	05-876-FO
	Data e regjistrimit: / Датум регистрације: / Date of registration:	22.06.2021
C	Të dhënat personale: / Лични подаци: / Personal data:	
C.2	Pronari i njësisë: / Власник возила: / Owner of the vehicle:	
C.2.1	Mbiemri ose emri i biznesit: / Презиме или назив предузећа: / Surname or business name:	Beshir Bajraktari B.I.
C.2.2	Emri: / Име: / Name:	
C.2.3	Adresa: / Адреса: / Address:	Maxhistrale - Ferizaj - Prishtinë Ferizaj
B	Data e regjistrimit të parë: / Датум прве регистрације: / Date of first registration:	01.02.2001
D	Automjeti: / Возило: / Vehicle:	
D.1	Prodhuesi: / Произвођач: / Make:	IVECO
D.2	Tipi: / Тип: / Type:	MH260E35

D3	Përshkrimet komerciale: / Комерцијални опис: / Commercial description(s):	Cursor
E	Numri identifikues i automjetit: / Идентификациони број возила: / Vehicle identification number:	WJME2NP0004232860
S	Viti i prodhimit: / Година производње: / Year of production:	2001
S	Kapaciteti i ulëseve: / Капацитет места за седење: / Seating capacity:	3
S.1	Numri i ulëseve: / Број места за седење: / Number of seats:	
S.2	Numri i vendeve për qëndrim: / Број места за стојање: / Number of standing places:	
Q	Raporti Fuqi/Peshë [në kW/kg]: / Однос Снага/маса [у кВ/кг]: / Power/Weight ratio [in kW/kg]:	
F	Pesha: / Маса: / Mass:	26000
F1	Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar: / Највећа дозвољена маса: / Maximum permissible laden mass:	14500
G	Pesha e automjetit: / Маса возила: / Mass of the vehicle:	11500
K	Homologimi: / Хомологација: / Type of approval:	

P	Motori: / Мотор: / Engine:	
P1	Kapaciteti (në cm3): / Запремина (у cm3): / Capacity (in cm3):	7790
P2	Fuqia maksimale neto (në kW): / Максимална нето снага (у кВ): / Maximum net power (in kW):	
P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjisë: / Врста горива или извора енергије: / Type of fuel or power source:	Dizel - EURO 2
R	Ngjyra e automjetit: / Боја возила: / Color of the vehicle:	0/3 - E BARDHË/E KUQE
2A	Ndërtimi: / Конструкција: / Construction:	Kamion me Kran me 2 dyer

Shënime: / Напомене: / Remarks:

N.P.T. " Beshi Com "

KONTRATË PËR DHËNIEN ME QERA TË PAISJEVE NR.01/11

Kontratë e lidhur me date: 18/11/2024, në mes të palëve kontraktuese:

1. QIRADHËNËSI: **Beshir Bajraktari B.I** me Çertifikatë të Regjistrimit nr: 810670225 i perfaqësuar nga z. Beshir Bajraktar - Drejtor Ligjor
2. QIRAMARRËSI: **COMPANY MURSELI SHPK** me numer unik te biznesit: 810306010 nga Doganaj Kacanik, sipas autorizimit noterial lëshuar nga noter Selatin D. Shahini me nr. Rend LPR.Nr. 12828/2024 përfaqësuar nga: Diamant Murseli.

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kesaj kontrate është dhënia me qera e mjeteve (Kamioneve)

Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve minimum 5 tone.
Kamion autobartës kran për transportimin e automieteve të pa lëvizshme minimum 5 tone.

Neni 2

Paisjet sipas nenit 1 të kësaj kontrate ipen me qera duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës deri në përfundimin e projektit:

Titulli: MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA-RITENDER

Me nr. të prokurimit: 214-24-12073-2-2-5 ; Nr I mbrendshem: 214/24/145/225

Investitori: POLICIA E KOSOVËS

Neni 3

Palët kontraktuese janë marrë vesh që qiraja mujore për paisjet e dhëna me qira të caktohet në shume prej 100 ero dita rast se kompania, **COMPANY MURSELI SHPK**, është fituese dhe pagesa do tëbëhet pas fillimit të inkasimit të mjeteve nga investitorët,

Pra mund ti shihni edhe Fotot e këtij mjeti:

05 876 FQ

Pra AK ne vend qe ta eliminoj këtë OE, kundërligjshëm e ka shpërblyer me kontratë.
Neve me datën 12.12.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se për te ja bere me dije se ka bere shkelje te dispozitave ligjore dhe për ta korrigjua gabimin e vet qe ka vendosur ne kundërshtim me kërkesat e veta dhe dokumentacionin te cilin e ka patur ne dispozicion por AK as qe ka marre mundin qe ta shqyrtoj pretendimin tone pasi qe e kemi patur vetëm një pretendim por AK merret me pretendime tjera te cilat neve nuk i kemi patur ne kërkesën për rishqyrtim dhe na "kercnon" me kinse te metat e ofertës tone për te na detyrua qe te heshtim dhe AK te vazhdoj me shkelje.

AK me datën 13.12.2024 ne përgjigjen për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim vetëm thotë se OE i rekomanduar për kontrate e plotëson kërkesën e AK-se njëjtë sikurse siç e kemi ofruar edhe neve gjithashtu AK thotë se fotot qe i keni ilustruar nuk kane qene kërkesë ne dosje pra AK thua se nuk ka qene e interesuar fare te arrij deri tek e vërteta dhe as qe i ka interesuar te dije se çfarë kane kërkuar e çfarë ka ofruar OE i rekomanduar për kontrate atëherë pse ka vendosur kërkesa AK ne dosje te tenderit? Pse është krijuar komision për vlerësimin e ofertave? Është dashur AK ta shënon ne DT dhe NJK se tenderi do ti jepet atij OE qe oferton me çmimin me te lire edhe ne rregull jemi.

AK ne përgjigjen e kërkesës tone për rishqyrtim ka shënuar se kinse çmimet tona janë me te larta se OE i rekomanduar për kontrate gjithashtu edhe se, neve kemi marrëveshje mbi qiradhënieje dhe se pronari i asaj kompanie qenka i dënuar pra AK ne mënyrë te drejtpërdrejtë ka tentuar te ma mbyll gojën dhe te mos e vazhdojmë me tutje me ankesa tona për këtë aktivitet, pasi qe AK e din mire se neve kemi ofertuar te vetëm ne këtë aktivitet dhe nuk jemi ne konzorcium me asnjë OE tjetër.

AK nëse ka patur prova qe neve kemi qene te pa përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit është dashur qe te na eliminoj e jo te na dërgoj letrën standartde si tenderues i pa suksesshëm.

AK neve na ka dërguar letrën standarde si tenderues i pa suksesshëm dhe nëse një OE i dërgohet kjo letër atëherë ai OE është vlerësuar si i përgjegjshëm nga ana e AK-se por qe ka ofertuar me çmimin me te shtrenjte, pra donë te thotë se i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT por çmimi ka qene me i shtrenjtë dhe sipas ligjit dhe Rregulloreve te KRKK-se (RRUOPP-se qe neve i nënkuptojmë rregullat dhe udhëzuesit e KRPP-se te cilat gjithmonë janë ne fuqi) Kandidati qe i plotëson te gjitha kërkesat e AK-se dhe e ka çmimin me te lire atëherë shpërblehet me kontrate. Ndërsa për AK-Policia e Kosovës po vlejnë rregulla tjera pra ata po i konsideruakan te gjithë kandidatet e përgjegjshëm pa ma rre

parasysh me çka kane ofertuar por vetëm ai kandidat qe e ka çmimin me te lire edhe shpallet fitues.

Pra shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe ne piken 2 thuhet : *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

AK nuk i ka vlerësuar ne mënyrë te barabarte te gjithë OE-te te cilët kane aplikuar ne këtë aktivitet te prokurimit. Pra nëse një tender është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e vendosura ne NJK dhe DT atëherë ai tender është i përgjegjshëm dhe shihet haptas se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59.4 te LPP-së ku thuhet: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm** me **Çmimin më te ulët**, ku neve kemi ofertuar me ofertuar me Tender të **përgjegjshëm** dhe me **Çmimin më te ulët**.

Pra neve jemi te vetmit që kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe me Çmimin më te ulët.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP e ta detyroj AK-në qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi dhe ti respektoj kërkesat e veta qe vet i ka vendosur ne NJK dhe DT lidhur ne këtë aktivitet te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik: **"All Stone" SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit: MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA-RITENDER me nr. te prokurimit: 214-24-12073-2-2-5 te iniciuar nga AK- POLICIA E KOSOVËS.

II. ANULOHET njoftimi për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA-RITENDER me nr. te prokurimit: 214-24-12073-2-2-5 te iniciuar nga AK-POLICIA E KOSOVËS, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet per sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne pergaditjen e kerkesave per rishqyrtim ashtu edhe per pergaditjen e ankeses. Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*